



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4/15 prot.

Fushë-Arrëz, më 30.12.2025

VENDIM

Nr. 51, datë 26.12.2025

**PËR DHËNIE TITULLI “QYTETAR NDERI” I BASHKISË FUSHË-ARRËZ
Z. KOL TOPLANA (PAS VDEKJES)**

Bazuar në: Neni 54/m, Neni 8 pika 2, Neni 9 pika 1.1/b të Ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar; Neni 3 pika 1, Neni 15 pika 1/a, Neni 17, Neni 19 të Ligjit nr. 112/2013 "Për Dekoratat, Titujt e Nderit, Medaljet dhe Titujt Vendorë të Nderit në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar; Neni 3 pika 1, Neni 4, Neni 9 pika 1, të Ligjit Nr. 94/2022, "Për Titujt e Nderit dhe Titujt Vendorë të Nderit"; Vendimi Nr.444, datë 16.10.2025 i Autoritetit Për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit; si dhe në relacionin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë Fushë-Arrëz dhe me propozimin e një grupi intelektualësh nga komuniteti, **Këshilli i Bashkisë Fushë-Arrëz, në mbledhjen e datës 26.12.2025,**

VENDOSI

T'i jepet titulli “Qytetar Nderi” i Bashkisë Fushë-Arrëz, **Z. Kol Toplana** me motivacionin: **“Për kontribut të jashtëzakonshëm në çështjen kombëtare, zhvillimin ekonomik të zonës, ruajtjen e traditës dhe kulturës shqiptare, pajtimin e gjaqeve, shërbimin ndaj komunitetit dhe rolin e tij si figurë shembullore e ndershmërisë, urtësisë dhe vlerave më të larta qytetare”**

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Këshilli i Bashkisë.

Ky vendim hy në fuqi bazuar në Ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" neni 55 pika 6.

Vendimi u miratua nga Këshilli Bashkiak me:

14 vota pro

0 vota kundër

0 vota abstenim

Zbardhur, më 30.12.2025.

SEKRETAR

Naze SELIMAJ

KRYETAR

Nikolin BARDHOKU



Adresa: Rruga Qendër, Bashkia Fushë-Arrëz

email: info@bashkiafushearrez.gov.al